



KATALOGU I PROVIMIT  
**G J U H Ë S H Q I P E**  
**D H E L E T Ë R S I**

PROVIMI PROFESIONAL NË SHKOLLAT PROFESIONALE KATËRVJEÇARE

VITI SHKOLLOR 2010/2011

**Katalogun e provimit e përgatiten:**

**Hava Pereziaqi**, SHMP „V.Bashkimi” Ulqin  
**Mr. Rrok Gjolaj**, Gjimnazi „25 Maji” Tuz  
**Mr. Haxhi Shabani**, Gjimnazi „Drita” Ulqin  
**Sehad Lulanaj**, Gjimnazi „25 Maji” Tuz  
**Luigj Berisha**, Qendra e Provimeve, Podgoricë

**Recensent:** Mr. Anton Gojçaj, Enti për Shkollim

## **PËRMBAJTJA**

1. Hyrje.....	4
2. Rregullat .....	5
3. Qëllimet e përgjithshme .....	6
4. Struktura dhe vlerësimi i provimit .....	7
4.1. Skema e provimit .....	7
4.2. Llojet e detyrave/pyetjeve .....	7
5. Programi i provimit.....	8
5.1. Të lexuarit dhe të kuptuarit e tekstit funksional.....	8
5.2. Gjuhë.....	8
5.3. Letërsi.....	9
5.4. Të shprehurit me shkrim.....	10
5.5. Veprat letrare të obliguara.....	10
6. Shembulli i testit .....	11
7. Fleta për përgjigje .....	20
8. Zgjidhja e testit me skemë për vlerësim .....	22
9. Literatura .....	26

# 1. HYRJE

Provimi Profesional në sistemin arsimor të Malit të Zi fillon të futet në vitin shkollor 2010/2011 dhe paraqet kontrollimin ekstern të standardizuar të arritjeve shkollore të nxënësve në fund të arsimimit profesional katërvjeçar. Në bazë të Ligjit për arsimimin profesional ("Fleta zyrtare e RMZ", nr. 64/02 e 28. 11. 2002, 49/07 e 10. 08. 2007, dhe "Fleta zyrtare e RMZ" 45/10 e 04. 08. 2010), Provimi Profesional jepet në mënyrë ekstern (neni 82), kurse për përgatitje të materialit të provimit dhe zbatimin e procedurës së provimit është e ngarkuar Qendra e Provimeve.

Kontrollohen njohuritë, aftësitë dhe shkathtësitë të cilat bazohen në pjesët kryesore të Programit të lëndës, që duhet t'i dinë nxënësit në fund të vitit të katërt të shkollës së mesme profesionale.

Në katalogun e provimit janë cekur qëllimet e përgjithshme të provimit, është përshkruar struktura e provimit, kurse me formën e qëllimeve të provimit saktësisht është thënë përmbajtja e lëndës që i nënshtrohet provimit. Në të ndodhet edhe shembulli i testit me skemë për vlerësim.

## 2. RREGULLAT

Provimi nga Gjuha shqipe dhe letërsia do të mbahet në kushte të njëjta dhe në mënyrë të njëjtë për të gjithë nxënësit e vitit të katërt të shkollës së mesme profesionale.

Materiali i provimit do të paktohet në qese të veçanta dhe të sigurta, të cilat do të hapen para nxënësve menjëherë para fillimit të provimit.

Në provim nuk lejohet:

- prezantimi i rrejshëm,
- hapja e detyrave të provimit para kohës së lejuar,
- pengimi i nxënësve tjerë,
- shfrytëzimi i mjeteve të palejuara,
- dëmtimi i shifrës në librezën e testimit,
- mosrespektimi i shenjës për përfundimin e provimit.

**Mjetet e lejuara:** lapsi i thjeshtë, goma dhe lapsi kimik/stilolapsi.

Punimi i nxënësit **duhet** të jetë i shkruar me laps kimik/stilolaps.

Pas provimit, testet do të paktohen dhe do të kthehen në Qendrën e Provimeve, ku do të organizohet vlerësimi i tyre.

### 3. QËLLIMET E PËRGJITHSHME

Pas përfundimit të vitit të katërt të shkollës së mesme profesionale, nxënësi duhet:

- ta njohë normën gjuhësore dhe normën drejtshkrimore dhe t'i zbatojë ato me përpikëri
- ta kuptojë: përmbajtjen dhe rëndësinë e tekstit letrar dhe përmbajtjen dhe qëllimin e tekstit joletrar
- ta vlerësojë i pavarur tekstin, t'i shpjegojë dhe t'i argumentojë pohimet e veta
- të dijë ta shkruajë tekstin funksional

## 4. STRUKTURA DHE VLERËSIMI I PROVIMIT

### 4.1. Skema e provimit

(provimi zgjat **150** minuta dhe punohet pa pushim)

**Pjesa e parë e provimit 75 minuta**

detyrat/pyetjet nga gjuha dhe letërsia

**Pjesa e dytë e provimit 75 minuta**

shkrimi i tekstit funksional

Përmes detyrave/pyetjeve në pjesën e parë të provimit nxënësi duhet të tregojë se

- e kupton përmbajtjen dhe qëllimin e tekstit letrar/përmbajtjen dhe rëndësinë e tekstit joletrar
- i njeh dhe i shfrytëzon shprehjet historiko-letrare dhe shprehjet teoriko-letrare
- di ta analizojë tekstin (pjesën apo fjalinë)
- i njeh rregullat gramatikore dhe drejtshkrimore

Me shkrimin e tekstit funksional nxënësi duhet të tregojë se

- e kupton temën
- di që në bazë të udhëzimeve hartimin ta shkruajë qartë dhe rrjedhshëm
- di t'i shpjegojë përjetimet e veta
- di t'i argumentojë pohimet e veta
- di t'i përdorë shprehjet përkatëse
- di t'i zbatojë drejt rregullat gramatikore dhe drejtshkrimore

Pjesa e parë e provimit merr pjesë në vlerësim deri në 70%

Pjesa e dytë e provimit (shkrimi i tekstit funksional) merr pjesë në vlerësim deri në 30%.

Rezultati i nxënësit/ i nxënësës në test do të caktohet si në vijim: numri i pikëve të fituara nga zgjidhja e pjesës së parë të provimit, në rezultatin e përgjithshëm, merr pjesë me 70%, kurse pikët e fituara nga shkrimi i tekstit funksional marrin pjesë me 30%. Suksesi i arritur do të shprehet me përqindje, i rumbullakuar në dy dhjetëshe.

P. sh. nëse nxënësi me zgjidhjen e detyrave të pjesës së parë të provimit fiton 17 nga 35 pikë të mundshme ose 8 nga 10 pikë të mundshme në hartimin e tekstit funksional, rezultati i tij përfundimtar llogaritet si në vazhdim:

$$70/100 \times 17/35 + 30/100 \times 8/10 = 0,34 + 0,24 = 0,58, \text{ d.m.th. } 58\%$$

### 4.2. Llojet e detyrave/pyetjeve

► **detyrat/pyetjet e tipit të mbyllur**

- detyrat/pyetjet me zgjedhje të shumëfishtë  
(janë ofruar tri apo katër përgjigje prej të cilave njëra është e saktë; janë ofruar pesë ose gjashtë përgjigje prej të cilave dy ose tri janë të sakta)
- detyrat/pyetjet e zgjedhjes alternative  
(pyetjet PO - JO apo E SAKTË - E PASAKTË)
- detyrat/pyetjet që bashkohen  
(fjalët janë të grupuara në dy kolona dhe duhet të bashkohen drejt)

► **detyrat/pyetjet e tipit të hapur**

- detyrat/pyetjet e përgjigjes së shkurtër  
(duhet shkruar fjalën, sintagmën, fjalinë apo shpjeguar diçka në dy-tri fjali)
- detyrat/pyetjet e përgjigjes së gjatë  
(shkrimi i tekstit funksional)

Llojet e detyrave	Gjuhë	Letërsi	Të shprehurit me shkrim	Gjithsej
Detyrat e tipit të mbyllur	5 – 9	5 – 11	–	10 – 20
Detyrat e tipit të hapur	5 – 9	4 – 9	1 – 2	10 – 20
<b>Gjithsej</b>	<b>10 – 18</b>	<b>9 – 20</b>	<b>1 – 2</b>	<b>20 – 40</b>

## 5. PROGRAMI I PROVIMIT

### A Pjesa e parë e provimit

Nxënësi duhet të tregojë që di t'i zbatojë drejt rregullat gramatikore dhe drejtshkrimore si dhe që e kupton tekstin funksional dhe tekstin letrar duke u përgjigjur në pyetjet lidhur me tekstin e lexuar siç është: ftesa zyrtare, fletë-falënderimi, kërkesa, ankesa, letra publike, lajmi/raporti, teksti shkencor, krijimi popullor, artikulli shkencor, reportazhi, intervista, reklama, jetëshkrimi, komenti, eseja, portreti, teksti dhe fragmenti letrar.

### 5.1. TË LEXUARIT DHE TË KUPTUARIT E TEKSTIT FUNKSIONAL

Nxënësi duhet të dijë

- që në shembullin e tekstit të dhënë ta caktojë: autorin, temën, kujt i është kushtuar teksti; t'i gjejë dhe t'i shpjegojë të dhënat dhe lidhshmërinë e tyre
- që ta njohë dhe ta formulojë temën dhe motivet e tekstit; ta sqarojë domethënien e fjalëve të cituara nga teksti.

### 5.2. GJUHË

Nxënësi duhet të dijë

- zhvillimin historik të gjuhës shqipe në periudha të ndryshme
- të bëjë klasifikimin gjenetik të gjuhëve dhe gjuhës shqipe në kuadër të familjes së gjuhëve indoevropiane
- historinë e zhvillimit të gjuhës standarde dhe alfabetet e saj
- dialektet e gjuhës shqipe, veçoritë dhe karakteristikat e tyre në raport me gjuhën standarde
- të njohë shtresat e gjuhës (zhargonet dhe sociolektet, përdorimin dhe kuptimin e tyre)
- ndikimin e gjuhëve të huaja mbi gjuhën shqipe
- fonetikën e gjuhës shqipe, veçoritë dhe karakteristikat
  1. ndryshimet fonetike
  2. fonologjinë
  3. ndarjen e tingujve
  4. rrokjen
  5. drejtshkrimin
  6. drejtshqiptimin
  7. prozodinë
  8. theksin e fjalës



- morfologjinë e gjuhës shqipe, veçoritë dhe karakteristikat
- llojet e fjalëve dhe veçoritë gramatikore të sintaksës
- ndryshimin e fjalëve (lakimin, zgjedhimin)
- të përdorë drejt sistemin e rasave në të folur dhe në të shkruar
- foljen: kohët, mënyrat, vetat, zgjedhimet
- leksikologjinë e gjuhës shqipe, veçoritë dhe karakteristikat
- transkriptimin e rregullt të fjalëve të cilat janë shpesh në përdorim (p.sh. web site, e-mail...)
- kategoritë leksiko-semantike të fjalëve (homonimet, sinonimet, paronimet, antonimet, hiponimet)
- t'i njohë arkaizmat, dialektizmat, zhargonizmat, termet
- t'i njohë dhe t'i shpjegojë frazeologjizmat
- ta njohë drejtshkrimin e gjuhës shqipe
- përdorimin e shkronjës së madhe në shkrim
- t'i shkruajë shkurtesat
- t'i ndajë drejt fjalët në shkrim
- t'i njohë dhe t'i zbatojë rregullat e shenjave të pikësimit

### 5.3. LETËRSI

Nxënësi duhet të dijë

- në një tekst të dhënë t'i dallojë llojet, gjinitë letrare (lirikën, epikën, dramatikën) dhe llojet e letërsisë.
- që t'i njohë periudhat letrare nga antika deri te letërsia bashkëkohore (përfaqësuesit kryesorë dhe veçoritë stilistike), të bëjë dallimin e veçorive stilistike të periudhave letrare.
- ta njohë dhe ta formulojë temën dhe motivet e tekstit; ta shpjegojë rëndësinë e fjalëve të cituara nga teksti
- t'i veçojë figurat stilistike në tekst (krahasimin, epitetin, simbolin, hiperbolën, anaforën, epiforën, refrenin, metaforën, metoniminë, eufemizmin, alegorinë, asindetin, polisindetin, ironinë) dhe ta shpjegojë përdorimin e tyre.
- t'i njohë elementet e vargëzimit (trokeun, jambin, daktilin) cezurën, rimën.
- t'i dallojë nocionet: autori, narratori, subjekti lirik, sistemin e personazheve (personazhin kryesor, personazhin dytësor, personazhin episodik)
- t'i dallojë termet personazhi dhe personaliteti, të kuptojë nocionin e motivimit në ndërtimin e personazhit letrar, ta përshkruaj personazhin nga vepra (portretin e jashtëm dhe të brendshëm, motivimin social dhe psikologjik...)
- t'i njohë dhe t'i dallojë nocionet: përmbajtja, fabula, syzheu, episodi dramatik, digresioni.
- t'i njohë dhe t'i kuptojë karakteristikat e këngës epike dhe të epit (dhjetërokëshin, heksametrin)
- ta njohë natyrën e poezisë (sipas motiveve: atdhetare, shoqërore, filozofike, erotike, përshkruese dhe sipas llojit: vargu i lire, soneti, elegjia, himni)
- ta njohë natyrën e tekstit dramatik, tekstin didaskalik, monologun, dialogun, njësinë e veprimit të dramës dhe etapat e zhvillimit të ngjarjes.
- ta njohë antidramën dhe gjuhën e saj skenike

### **B** Pjesa e dytë e provimit-kultura e gjuhës në praktikë

Nxënësi duhet të dijë t'i shkruajë: fletëfalënderimin, kërkesën, ankesën, letrën zyrtare, letrën jozyrtare, urimin, shpalljen, lajmin, raportin.

Nxënësi të respektojë:

- udhëzimet për shkrim të tekstit, formën e tekstit dhe parimet e formulimit

- (hyrjen, përpunimin, përfundimin, pasuset, shkrimin e emërtimeve të vendeve, datave, adresave, si t'u drejtohet personave, emrin dhe mbiemrin e të adresuarit, margjinat...)  
 → ta ketë parasysht kuptueshmërinë, lidhshmërinë dhe formësimin e tekstit.  
 → normën drejtshkrimore dhe gramatikore

#### 5.4. TË SHPREHURIT ME SHKRIM

Nxënësi të di të shkruajë: kërkesën, letrën jozyrtare, urimin, lajmin.

Nxënësi të respektojë:

- udhëzimet për shkrim të tekstit, formën e tekstit dhe parimet e formulimit (hyrjen, përpunimin, përfundimin, shkrimin e emërtimeve të vendeve, datave, adresave, emrin dhe mbiemrin e të adresuarit.

#### 5.5. VEPRA LETRARE TË OBLIGUARA

##### VEPRAT LETRARE TË OBLIGUARA

### I

**Homeri:** „Iliada“ (kënga e 6-të dhe e 18-të)

**Sofokliu:** „Antigona“

**F. Petrarka:** „Kanonieri“ (fragment)

**Servantesi:** Don Kishoti (fragment)

**M. Barleti:** „Historia e Skenderbeut“ (fragment)

### II

**Heminguej:** „Plaku dhe deti“

**J. de Rada:** „Këngët e Serafina Topisë“

**N. Frashëri:** „Bagëti e Bujqësia“

**Ndre Mjeda:** „Andrra e jetës“

**P.P. Njegosh:** „Kurora e maleve“ (fragment)

### III

**Sharl Bodleri:** „Albatrosi“

**Gëte:** „Vuajtjet e Vërterit të ri“

**Lasgush Poradeci:** „Vdekja e Nositit“

**D. Agolli:** „Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo“

**Ali Podrimja:** „Drejtëshimi“

### IV

**A. Kamy:** „I huajti“ (fragment)


**Gj. Fishta:** „Lahuta e Malcisë“

**I. Kadare:** „Viti i mbrapshtë“

**F. Kongoli:** „Ëndrra e Damokleut“ (fragment)

## 6. SHEMBULLI I TESTIT

Me kujdes lexo tekstin nga Katalogu i botimeve të një shtëpie botuese pastaj përgjigju në pyetjet 1, 2, 3, 4 dhe 5.

KATALOGU I BOTIMEVE	Redaktor Dragan K. Vukçević	
<p>Botuesi <b>CID</b></p> <p>Podgorica, Obala Ribnice 4/II Tel. 081/230-122, 230-126 Beograd, Majke Jevrosime 44/I Tel.Fax. 011/32-48-021</p> <p>Kryeredaktor e redaktor përgjegjës <b>Dragan K. Vukçević</b></p> <p>Drejtor <b>Zharko Radonjić</b></p> <p>Redaktor teknik <b>Darko Manojlović</b></p> <p>Referent për shitje <b>Ratko Bojanović</b> Tel. 081/230-126</p> <p>Përgatitja grafike <b>SCANNER STUDIO</b> Beograd, Zaplanjska 86 011/469-522; 491-338</p> <p>Shtyp Grafolik Beograd, Vojvode Stepe 375</p>	<p><b>MEMOARET</b> Popović, Simo Botimi I, 1995 17× 24 cm. 875 faqe, lidhja e fortë</p> <p><b>LETRA PËR ADRIATIKUN DHE MALIN E ZI</b> Marmije, Gzavije Botimi 1995 13 x 21 cm. 207 faqe, lidhja e fortë</p> <p>Në botim:</p> <p>H. V. Mandere MALI I ZI</p> <p>J. Holçek MALI I ZI NË PAQE</p> <p>A. Bulonj MALI I ZI DHE POPULLATA E TIJ</p> <p>M. P. Varava NËPËR MAL TË ZI</p> <p>F. Lanorman TURQIT DHE MALAZEZËT</p> <p>H. Shtiglic VIZITË NË MALIN E ZI</p> <p>Sh. Irijart BRIGJET E ADRIATIKUT</p>	 <p>Shitur:</p> <p>P. I Petroviq LETRA V. de Somier UDHËTIMI HISTORIK DHE POLITIK NË MAL TË ZI</p> <p>A. Avelo, Zh. de la Nezijer MALI I ZI DHE HERCEGOVINA</p> <p>N. Rajković SENATI I MALIT TË ZI J. Holçek MALI I ZI V. Denton MALI I ZI, POPULLI DHE HISTO- RIA E TIJ</p> <p>Gj. Markoti MALI I ZI DHE FEMRAT E TIJ Z. Miliq DARKA E HUAJ S. M. Martinović MEMOARET J. Vaclik SOVRANITETI I MALIT TË ZI V. Bronevski SHËNIME PËR MALIN E ZI DHE BOKËN</p>

1. Si quhet shtëpia botuese nga katalogu i së cilës janë dhënë faqet?

.....  
(1 pikë)

2. Me kujdes lexo tekstin e katalogut në anën e majtë dhe pastaj zhvillo detyrën. Përshkruaj fjalët, gjegjësisht sintagmat të cilat tregojnë funksione ose veprime që kryejnë personalitetet e numëruara.

.....  
(1 pikë)

3. Me vëmendje lexo tekstin e katalogut në anën e djathtë dhe pastaj zhvillo detyrën. Çfarë informacionesh u ofron shfrytëzuesve ky katalog?

.....  
.....

(1 pikë)

4. Rretho shkronjën para titullit të librit i cili është në proces të shtypjes dhe pastaj zgjidhjen kaloje në fletën për përgjigje.

- A. Letrat për Adriatikun dhe Malin e Zi
- B. Mali i Zi dhe popullata e tij
- C. Mali i Zi dhe femrat e tij

(1 pikë)

5. Në tekstin në krahun e djathtë pranë titullit dhe emri të autorit të librit të botuar ndodhen edhe të dhëna shtesë. Shkruaj se për çfarë informacionesh është fjala.

.....  
.....

(1 pikë)

Në bazë të tekstit në vijim përgjigju pyetjeve 6 dhe 7.

#### MIRËINFORMIMI I QYTETARËVE NDIHMON NË LUFTËN KUNDËR KORRUPSIONIT

Ekspertët thonë se ekziston gjithmonë dikush që përdor pozitën në shërbim të interesit të tij personal, por media e lirë dhe gjykatat e pavaruara mund të ndihmojnë për ta luftuar këtë fenomen. Ata thonë se kur qytetarët janë të mirëinformuar, ata janë në gjendje të sjellin ndryshime edhe në këtë aspekt. Ndër format e tjera të korrupsionit janë nepotizmi, ose favorizimi i personave të familjes apo miqve, falsifikimi i regjistrave të biznesit, ose shkëmbimi i aksioneve të bursës duke u bazuar tek informacionet e fshehta.

Luiz Shelli punon për Qendrën e Krimin dhe Korrupsionit Ndërkombëtar, pranë Universitetit Amerikan, në Uashington. Ajo thotë se korrupsioni është një problem i madh në vendet e varfëra me një ekonomi të dobët. Ajo shpjegon se vendet, ekonomia e të cilave varet nga një burim natyror i vetëm janë më në rrezik sepse një numër i vogël njerëzish kontrollojnë të ardhurat e burimit. Zonja Shelli thotë se korrupsioni mund të luftohet nëpërmjet instituteve të forta publike dhe private, si gjykata të pavarura dhe mjete të lira informimi. Bizneset kanë gjithashtu ndikimin e tyre.

Ekspertja e korrupsionit, Nensi Brosuell, e organizatës Transparency International, thotë se veprimet e bizneseve kanë efekt tek njerëzit më të varfër. Sipas kësaj organizate, Islanda është në vendin e parë si shteti më i pakorruptuar, ndërsa Çadi ndodhet në vendin e fundit të listës me 159 shtete si vendi me korrupsion më të lartë.

6. Sipas Luiz Shell, në cilat vende të botës ka korrupsion më shumë?

.....  
.....


(1 pikë)

7. Cili është shteti më i pakorruptuar dhe cili është shteti më i korruptuar sipas organizatës Transparency International?

.....  
.....

(1 pikë)

8. Në urimin në vazhdim vëreje gabimin dhe përmirësoje atë.



.....  
.....  
(1 pikë)

9. Folja kam është përdorur si folje ndihmëse në fjalinë:

- A. Unë e kam telefonin tënd
- B. Pata shumë keq për atë që ju ndodhi
- C. E kam ndihmuar gjatë gjithë kohës

Rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen kaloje në fletën për përgjigje.

(1 pikë)

10. Rretho shkronjën para shkurtesës së shkruar drejt nga fjala doktor dhe zgjidhjen kaloje në fletën për përgjigje.

- A. Dr
- B. Dr.
- C. Dokt.

(1 pikë)

11. Rretho shkronjën para fjalës së shkruar drejt:

- A. shduk
- B. zhduk
- C. çduk

(1 pikë)

12. Cili ndryshim fonetik ka ndodhur në fjalën DESH?

- A. mosekzistimi i A-së
- B. humbja e A-së
- C. kalimi i A-së në E

Rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen kaloje në fletën për përgjigje.

(1 pikë)

13. Shkruaj shkallën krahasore të mbiemrave:

I gjatë - .....  
I madh - .....

(2 pikë)

**14. Cila fjalë nuk mund të ndahet në rrokje?**

- A. shkëmb
- B. frenoj
- C. kope
- D. tjetërsoj

(1 pikë)

**Lexo vjershën e Bodlerit „Albatrosi” pastaj përgjigju në pyetjen 15.**

*Albatrosi*

*Shpesh për zbavitje, detarët në lundrim,  
Marrin albatrosë, ca zogj të mëdhenj deti  
Që ndjekin anijen me përtim në rrugëtim  
Kur kjo rrëshqet mbi zgavra tmerri.*

*Sapo mbi dërrasa, ata i lëshojnë,  
Këta mbretër të hapësirës së kaltër  
Ulin me dhimbje flatrat që bardhojnë,  
Si lopata lundrimi në rërën e lagësht.*

*Ky udhëtar me krahë bëhet i plogët  
Shformohet dhe shëmtohet, s'ka më bukuri,  
Dikush i prek me llullë sqepin e dobët,  
Tjetri e përtall, çalon përbri tij.*

*Poeti ngjason, me këtë princ kaltërsish,  
Që sfidon shigjetarin, përqesh stuhinë  
Po kur në tokë ai ulet sërish  
Krahët gjigandë si pengesa i rrinë.*

**15. Çfarë është kuptimi i jetës së artistit në poezinë “Albatrosi”?**

- A. Artisti gjithmonë ka një pozitë të privilegjuar në shoqëri.
- B. Artisti është madhështor kur merret me çështje madhore, por jo i shkathtë e gati qesharak kur merret me gjëra të përditshme
- C. Artisti gjithmonë është i penguar dhe nuk ka mjaft liri.

**Rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen kaloje në fletën për përgjigje.**

(1 pikë)

**Lexoje tekstin në vijim dhe përgjigju pyetjeve 16 dhe 17.**

*BAGËTI E BUJQËSIA*

*O malet e Shqipërisë! E ju o lisat e gjatë,  
Fushat e gjera me lule, q'u kam nër mënt dit' e natë  
Do të këndoj bagëtinë, që mbani ju e ushqeni,  
Ti Shqipëri, më ep nderë, më ep emërin Shqipëtar"  
Zemërën ti ma gatove plot me dëshirë dhe me zjarr.  
Shqipëri! O mëma ime! Ndonëse jam i mërguar,  
Dashurinë tënde kurrë, zemëra s'e ka harruar.  
Ku i fryn bariu xhurasë, tek kullosin bagëtia,  
Ku mërzen cjapi me zile, atje i kam mënt' e mija  
Atje lint diell'i qeshur edhe hëna e gëzuar,  
Mendja! merr fushat e malet, jashtë, jashtë nga qyteti  
Nga brenga, nga thashethemet, nga rrëmuja, nga rrëmeti-  
Vashë bukurosh' e bariut që vjen me llërë përveshur,  
Me zemërë të dëfryer e me buzëzë të qeshur,  
Me dy shqerazë ndër duar të bukura, si dhe vetë.*

*Naim Frashëri*

**16. Këtë fragment e përshkon fryma:**

- A. romanike
- B. realiste
- C. humaniste

**Rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen kaloje në fletën për përgjigje.**

*(1 pikë)*

**17. Çka mban në mend poeti ditë e natë?**

.....  
.....

*(1 pikë)*

18. Nën pjesët e veçuara shkruaj titujt e veprave nga të cila janë shkëputur ato dhe autorët e tyre.

- 1) *Prej kah fill xen rriba e Verit  
e m' Vezuv t' veshun n' gjineshtra  
Kur Kankazit e n' Shkamb të Doverit  
Ku rri Albona e pjek gënjeshtra,  
fis ma t' vjetër kund nuk ka  
se asht ky fis n' za i Shqiptarit  
në mes t' cilit punët e mëdha  
për Europë xunë t' enden sparit.  
Po, m' këto male e karpa tona  
spari Zeusi njerztë i rysi  
e me augure te Dodona  
egërsinë ai ua përmbysi:  
Këtu edhe sparit Orë e Zana  
nisën valle me vallëzua  
e n për vërrije e fusha t' gjana  
Xu pegasi me lodrue.*

- 2) *Vuk Mandushiq  
Më të bukur se zana e ka  
mbushur s'i ka të tetëmbëdhjetat  
zembrën gjallë ma ka rrëmbyer*
- Princ Jankoja  
Për ç' gjë zembrën ty ta ka rrëmbyer?*

(2 pikë)

Me kujdes lexo vargjet e poezisë së Nolit "Shën Pjetri në mangall, pastaj përgjigju në pyetjet 19, 20 dhe 21.

Fryn' e çfryn veriu,  
Ngrin, **mërdhin** i ziu  
Dhe mangallit i afrohet  
Që të **ngrohet**.

(...)

Kruspull mi mangallin mblidhet,  
Po djek dorën dhe përdridhet;  
Se ç' këndon bandill këndezi  
Nga **qymezi**:

19. Strofat e veçuara janë:

- A. strofa dyvargëshe (distik)  
B. strofa trevargëshe (tercet)  
C. strofa katërvargëshe (katren)

Rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen kaloje në fletën për përgjigje.

(1 pikë)



**20. Fjala e nënvizuar në strofën e dytë është:**

- A. arkaizëm
- B. barbarizëm
- C. neologjizëm

Rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen kaloje në fletën për përgjigje.

(1 pikë)

**21. Fjalët e theksuara (të errësuara) në strofën e parë janë:**

- A. homonime
- B. antonime
- C. sinonime

Rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen kaloje në fletën për përgjigje.

(1 pikë)

**Lexo me kujdes fragmentin nga romani "Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo" të shkrimtarit Dritëro Agolli dhe përgjigju në dy pyetjet në vazhdim.**

*"Prapë qesha, por këtë radhë me zë. Por papritur, pas kësaj qeshjeje, më pushtoi një trishtim i pakuptuar. Në ndërgjegjen time të dytë vinte jehona e raporteve. Kjo jehonë gjithnjë kështu më ndiqte. Edhe kur më shfaqej ndonjë gëzim i turbullt, jehona e raporteve godiste në muret e ndërgjegjes sime ma shuante këtë gëzim të pandezur. Edhe te shoku Zylo, - mendova me vete, - nuk do të shpëtoj nga raportet. Unë i duhem shokut Zylo, prandaj kërkoi të më mbajë pranë. Ta zemë se për një kohë ai do të më lërë të qetë. Pastaj? - pyeta veten. - Në mos më ngacmoftë shoku Zylo, do të më ngacmojë shoku Q. Edhe shokut Q i duhen raportet. Kurrizi yt, o Demkë, do t'i mbajë të gjitha letrat e nxira të futura në dosje të bardha!"*

**22. Në romanin "Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo" Demka është një figurë tragjike, sepse:**

.....

(1 pikë)

**23. Në romanin "Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo", autori e ka përdorur fjalën "shok" me kuptim:**

.....

(1 pikë)

**24. Në fjalitë e mëposhtme përdor shkronjën e madhe.**

Në qendrën e kulturës në ulqin u mbajt një veprimtari kulturore me rastin e javës së fëmijëve e cila në mal të zi kremtohet javën e parë të muajit tetor. Organizimi i këtij aktiviteti ka për qëllim shënimin simbolik të pranimit të nxënësve të klasave të para në lidhjen e fëmijëve.

.....  
.....  
.....  
.....

(4 pikë)

**25. Domethënie e leksemës rruga në shembullin E TËRË RRUGA FLEN është krijuar me mekanizmin stilistikl që quhet:**

- A. metaforë
- B. metonimi
- C. sinekdoka

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen kaloje në fletën për përgjigje.

(1 pikë)

**26. Çka është frazeologjizëm?**

- A. Kush punon, fiton.
- B. Ai që di të bëjë lajka, di edhe të shpifë.
- C. Shkel e shko.

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen kaloje në fletën për përgjigje.

(1 pikë)

**Me kujdes lexo fragmentin nga vepra e Kadaresë "Gjenerali i ushtrisë së vdekur" dhe përgjigju në pyetjet 27, 28 dhe 29.**

Gjeneralit i ra pija në kokë. Unë kam tani një ushtri të tërë të vdekurish, mendoni. Vetëm se ata tani, në vend të uniformës, kanë secili nga një thes najloni. Thasë të kaltër me dy vija të bardha dhe një shirit të zi, prodhim special "Olympias". Në fillim ishin ca skuadra. Pastaj u krijuan kompanitë, pastaj batalionet dhe tani po plotësohen divizionet dhe regjimentet. Një ushtri e tërë e mbështjellë me najlon.

(Pjesë nga vepra e I. Kadaresë)

**27. Cililit lloj letrar i takon vepra "Gjenerali i ushtrisë së vdekur"?**

- A. romanit
- B. dramës
- C. tragjedisë

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen kaloje në fletën për përgjigje.

(1 pikë)

28. Me një fjali shkruaj për çka bëhet fjalë në fragmentin e mësipërm të veprës së shkrimtarit tonë të njohur.

.....

.....

.....

(1 pikë)

29. Kush janë personazhet kryesore të kësaj vepre të Kadaresë?

.....

(1 pikë)

30.

Ndeshja finale e Kampionatit të 28-të evropian në vaterpool është zhvilluar me 13.7.2008 në Malaga në mes të përfaqësueses së Malit të Zi dhe asaj të Serbisë. Në kohën e rregullt të ndeshjes rezultati ishte i barabartë 5:5. Në vazhdimin e parë Nikolla Vukçeviq shënoi gol për reprezentacionin e Malit të Zi dhe i solli vendit të vet titullin e kampionit të Kontinentit të Vjetër në vaterpol me rezultat 6:5.

Teksti i dhënë është një lajm për fitoren e vaterpolistëve të Malit të Zi në Kampionatin evropian.

Këtë tekst zgjeroje në raport duke shfrytëzuar faktet që ndodhen në të dhe të dhënat shtesë:

- pjesëmarrje debutuese e përfaqësueses së Malit të Zi në Kampionatin evropian
- Serbia, deri atëherë kampione aktuale e Evropës
- rezultati nëpër çereke (2:1, 0:3, 2:0, 1:1)
- Millosh Shqepanoviq portier i përfaqësueses së Malit të Zi
- rasti i pashfrytëzuar i malazezëve për gol gjatë 20 sekondave të fundit për shkak të ndërhyrjes së gabuar
- medalja e parë e artë në Kampionatin e Evropës

Raporti duhet të shkruhet drejt gjuhësisht dhe pa gabime drejtshkrimore.

(10 pikë)

## 6. FLETA PËR PËRGJIGJE

Nxënësit bashkë me testin do të fitojnë edhe fletën për shënimin e përgjigjeve në detyrat me zgjidhje të shumëfishtë. Është e nevojshme që në vendin e duhur ME KUJDES t'i përshkruajnë përgjigjet e tyre.



### PROVIMI PROFESIONAL FLETA PËR PËRGJIGJE Gjuhë shqipe dhe letërsi

Shifra e nxënësit

Shëno kështu:



A B C	A B C
4. <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/>	16. <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/>
A B C	A B C
9. <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/>	19. <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/>
A B C	A B C
10. <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/>	20. <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/>
A B C	A B C
11. <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/>	21. <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/>
A B C	A B C
12. <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/>	25. <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/>
A B C D	A B C
14. <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/>	26. <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/>
A B C	A B C
15. <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/>	27. <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/>

PROVIMI PROFESIONAL  
FLETA PËR PËRGJIGJE  
Gjuhë shqipe dhe letërsi

Shifra e nxënësit

Shëno kështu:



	A	B	C
4.	<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

	A	B	C
9.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>

	A	B	C
10.	<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

	A	B	C
11.	<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

	A	B	C
12.	<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

	A	B	C	D
14.	<input checked="" type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

	A	B	C
15.	<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

	A	B	C
16.	<input checked="" type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

	A	B	C
19.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>

	A	B	C
20.	<input checked="" type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

	A	B	C
21.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>

	A	B	C
25.	<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

	A	B	C
26.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>

	A	B	C
27.	<input checked="" type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

## 7. ZGJIDHJA E TESTIT ME SKEMË PËR VLERËSIM

1.

CID/Shtëpia botuese CID/Botuesi është CID

**1 pikë**

2. Kryeredaktor e redaktor përgjegjës, drejtor, redaktor teknik, referent i shitjes

**1 pikë për përgjigje të saktë dhe të plotë**

Tregon kuptim të gabuar OSE jep përgjigje të pamjaftueshme OSE përgjigje të pacaktuar.

- Kryeredaktor e redaktor përgjegjës, drejtor, redaktor teknik, referent i shitjes, përgatitja grafike, shtyp (dhe përgjigje të ngjashme)

**0 pikë**

3.

Katalogu ofron informacione për librat që janë botuar dhe për ato që janë në botim. (dhe përgjigje të ngjashme)

**1 pikë**

4.

B.

**1 pikë**

5.

Cili botim është, vitin e botimit të librit, formatin e librit, numrin e faqeve të librit, llojin e përgatitjes.

**2 pikë për përgjigje të plotë dhe të saktë; 1 pikë për dy karakteristika të dhëna saktë**

6.

Në vendet e varfra me një ekonomi të dobët.

**1 pikë**

7.

Shteti më i pakorruptuar është Islanda, kurse më i korruptuari është Çadi.

**1 pikë**

8.

Gëzuar festat e **fundvitit** dhe gjithë të mirat në Vitin e Ri të dëshiron Brikena

**1 pikë**

9.

C.

**1 pikë**

10.

B.

**1 pikë**

11.

B.

**1 pikë**

12.

B.

**1 pikë**

**13.**

Më i gjatë

Më i madh

**Numri maksimal i pikëve 2.**

Ka shkruar saktë vetëm një krahasore:

Më i gjatë ose më i madh

**Numri i pjesshëm i pikëve 1.**

**14.**

A.

**1 pikë**

**15.**

B.

**1 pikë**

**16.**

A.

**1 pikë**

**17.**

Poeti mban mend ditë e natë malet e Shqipërisë, me lista e gjatë dhe fushat e gjëra me lule.

**1 pikë**

**18.**

1. Gjergj Fishta, "Lahuta e Malcisë"

2. P.P.Njegosh, "Kurora e maleve"

**2 pikë**

**19.**

C.

**1 pikë**

**20.**

A.

**1 pikë**

**21.**

B.

**1 pikë**

**22.**

E ka humbur vetveten

**1 pikë**

**23.**

Ironik

**1 pikë**

**24.**

Në Qendrën e Kulturës në Ulqin u mbajt një veprimtari kulturore me rastin e Javës së Fëmijëve e cila në Mal të Zi kremtohet javën e parë të muajit tetor. Organizimi i këtij aktiviteti ka për qëllim shënimin simbolik të pranimit të nxënësve të klasave të para në Lidhjen e Fëmijëve.

**Përdorimi i saktë i shkronjës së madhe në të gjitha fjalët = 4 pikë**

**Përdorimi i saktë i shkronjës së madhe në të paktën 6 fjalë = 2 pikë**

**Përdorimi i saktë i shkronjës së madhe në më pak se 6 fjalë = 0 pikë**

**25.**

B.

**1 pikë**

**26.**

C.

**1 pikë**

**27.**

A.

**1 pikë**

**28.**

Bëhet fjalë për ushtrinë e cila erdhi okupatore dhe u kthye e vdekur në najlon. Kemi të bëjmë me trimërinë shqiptare.

**1 pikë.**

**29.**

Gjenerali, prifti, plaka Nicë.

**1 pikë**

**30.**

Skema për vlerësim të raportit

**10 pikë**

P.sh.

Në Malagë, më 13 korrik 2008 në finalen e Kampionatit të 28-të të Evropës, vaterpolistët e Malit të Zi fituan deri atëherë kampionin evropian në fuqi përfaqësuesen e Serbisë, me rezultatin 6:5 duke u bërë kështu kampionë të Evropës. Ishte kjo paraqitja e parë e vaterpolistëve malazezë prej që Mali i Zi është bërë shtet i pavarur.

Në kohën e rregullt të lojës rezultati ishte 5:5 në vazhdimin e parë Nikolla Vukçević arriti të shënojë golin vendimtar për Malin e Zi, duke i siguruar kështu titullin e kampionit. Tërë kohën rezultati i ndeshjes ishte i pasigurt ashtu që rezultati në çerekët e lojës ishte (2:1,0:3, 2:0, 1:1). Në vazhdime, vaterpolistët e Serbisë asnjëherë nuk arritën të mposhtin portierin fantastik të Malit të Zi, Millosh Shqepanoviqin. Malazezët patën rast që në 20 sekondat e fundit të japin gol dhe të marrin medaljen e artë, por për shkak të një faulli u desh që të shkojnë në vazhdime. Paraprakisht Pijetllloviq një minutë e 16 sekonda para fundit të lojës e barazoi rezultatin.

Kështu kombëtarja debutuese e Malit të Zi arriti të fitojë medaljen e parë të artë në kampionatin e Kontinentit të Vjetër.

Janë të sakta të gjitha përgjigjet që janë të ngjashme me përgjigjen e ofruar, e që janë në pajtim me skemën për vlerësim.



Përmbajtja	Drejtskrimi	Lidhshmëria	Struktura ndërtimore e tekstit
<p>→ teksti plotësisht i përgjigjet temës së dhënë</p> <p>→ janë të pranishme të gjitha të dhënat e dhëna</p> <p>→ struktura gjegjëse</p> <p><b>2 pikë</b></p>	<p>→ respektimi i normës gramatikore (përdorimi i drejtë i rasave, foljeve pavetore, respektimi i rregullave të harmonisë, përdorimi i drejtë i kohës së kryer të thjeshtë, foljes ndihmëse jam, mendimi i tërësishëm i fjalisë, renditja e saktë e fjalëve...)</p> <p><b>2 pikë</b></p> <p>→ respektimi i normës drejtshkrimore (shkrimi i drejtë i shkronjës së madhe. Përdorimi me vend i shenjave të pikësimit.</p> <p><b>2 pikë gjithsej 4 pikë</b></p>	<p>→ lidhja e mirë në nivel të tekstit dhe paragrafëve</p> <p><b>2 pikë</b></p>	<p>→ përshtatja e organizimit të përgjithshëm dhe strukturës ndërtimore të tekstit, zhvillimit logjik të tij (qartë ndan pjesën hyrëse të raportit (nga pjesa e dytë e tij; ndan paragrafet.</p> <p><b>2 pikë</b></p>
<p>→ teksti i përgjigjet temës së dhënë, por i mungon një nga të dhënat e dhëna OSE 20-30% të tekstit të panevojshëm për temën e dhënë OSE</p> <p>→ hartimi i përgjigjet temës së shtruar, janë të pranishëm të gjitha të dhënat e vendosura, por punimi nuk ka strukturën e raportit (nuk përcjell rrjedhat e ngjarjes, por është shkruar si tekst i tregimit, letër ose ngjashëm) OSE</p> <p>→ njëlloj si për</p> <p><b>2 pikë</b></p> <p>→ por lexohet vështirë</p> <p><b>1 pikë gjithsej 3 pikë</b></p>	<p>→ respektimi i normës gramatikore me gabime të vogla (p.sh. gabimet semantike ...)</p> <p><b>1 pikë</b></p> <p>→ respektimi i normës drejtshkrimore me gabime të vogla (p.sh. heqjet e vogla të dorës nga përdorimi i normëzuar i shenjave të pikësimit, dhe nga norma e rregullimit të shqiptimit të fjalëve të huaja...)</p> <p><b>1 pikë gjithsej 2 pikë</b></p>	<p>→ lidhja e mirë në nivel të tekstit me palidhshmëri të përkohshme në shkallë të paragrafëve</p> <p><b>1 pikë</b></p>	<p>→ bën ndarjen e qartë të hyrjes, shtjellimit dhe përfundimit, por nuk ndan paragrafët brenda shtjellimit.</p> <p><b>1 pikë</b></p>

#### VËREJTJE:

► 0 (zero) pike ose në përmbajtje ose në gjuhë vlerësohet me notë të pamjaftueshme, si dhe hartimi jo i rregullt dhe i palexueshëm ose punimi me shembuj të leksikut të papërshtatshëm ose me temë të dështuar.

► Për dorëshkrim që nuk lexohet lehtë zbritet 1 pikë.

Pjesa I e provimit-numri i pikëve: **35** (70 %)

Pjesa II e provimit-shkrimi i lajmit dhe fletëparaqitjes me e-mail - numri i pikëve: **10** (30 %)

Numri i përgjithshëm i pikëve në test: **45** (100 %)

## 9. LITERATURA

Tekstet për programet me 3 orë mësimi të gjuhës shqipe dhe letërsisë në javë sipas zgjedhjes së mësimdhënësve.

- Prof. dr. Rami Memushaj, "Bukuria e gjuhës", Gjuha shqipe për klasën e parë të gjimnazit të përgjithshëm, Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore; Podgoricë 2007
- Prof. dr. Ardian Marashi, "Letërsia 1", për klasën e parë të gjimnazit të përgjithshëm, Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore; Podgoricë 2007
- Prof. dr. Rami Memushaj, "Bukuria e gjuhës", Gjuha shqipe për klasën e dytë të gjimnazit të përgjithshëm, Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore; Podgoricë 2008
- Prof. dr. Rami Memushaj, "Bukuria e gjuhës", Gjuha shqipe për klasën e tretë të gjimnazit të përgjithshëm, Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore; Podgoricë 2009
- Historia e letërsisë shqipe, Rilindja, Prishtinë, 1989
- Prof. Gjergj Zheji, Prof. As. Dr. Natasha Xhafka "Fjalor enciklopedik letrar", Tiranë, 2001
- Bahri Beci "Gramatika e gjuhës shqipe për të gjithë", Tiranë, 2004
- Grup autorësh "Mësuesi, shkolla dhe shoqëria", Prishtinë 1997
- Grup autorësh "Studio gjithçka, arsyet vendin e parë", Tiranë, 1998
- Bardhyl Musai "Metodologji e mësimdhënies", Tiranë, 2003
- Grup autorësh "Zhvillimi i mendimit kritik gjatë leximit dhe shkrimit", Tiranë, 1998
- Prof. Gjergj Zheji, Prof. As. Dr. Natasha Xhafka "Komenti letrar" (në ndihmë të mësuesve), Tiranë, 1998
- Sabri Hamiti "Vetëdija letrare", Rilindja, Prishtinë, 1989
- Dr. Agim Vinca "Struktura e zhvillimit të poezisë së sotme shqipe (1945-1980)", Rilindja, Prishtinë, 1985
- Bajram Krasniqi "Kode të ligjërimit letrar" Rilindja, Prishtinë, 1988
- Rexhep Ismajli "Gjuhë dhe etni", Rilindja, Prishtinë, 1991
- Ibrahim Rugova "Strategjia e kuptimit", Rilindja, Prishtinë 1980
- Anton Berisha "Shumësia kuptimore", Rilindja, Prishtinë, 1990
- Rexhep Qosja "Histori e letërsisë shqipe"(Romantizmi I, II, III), Rilindja, Prishtinë, 1984, 1986
- Milivoje Sollari "Teoria e letërsisë", Prishtinë, 1978
- R. Velek/ O.Voren "Teoria e letërsisë", Prishtinë, 1982
- Stefan Çapaliku "Letërsia e interpretuar", Tiranë, 1998
- Isuf Zeneli, Bazat e standardizimit dhe vlerësimit në arsim, Prishtinë, 2003





qendra e provimeve  
MASA E  
VËRTETË E  
NJOHURIVE

Vaka Đurovića bb, 81 000 Podgorica  
ic@iccg.edu.me, www.iccg.edu.me